

## VLERESIMI NE SHKOLLEN FILLORE

Te dashur prinder ,

Momenti i vleresimit eshte nje moment shume i rendesishem per ju dhe per femijet tuaj.

Shkolla fillore i prezanton dokumentin e vleresimit prinderve dy here ne vit, ne shkurt dhe ne korrik.

Duke filluar nga viti shkollor 2020/2021\* **dokumentat e vleresimit se shkolles fillore** do jene ndryshe nga ato te meparshmet.

### ME PERPARA

- Per secilen disipline (italisht, matematik, histori etj.) ishte parashikuar nje **NOTE E VETME** ne te dhjetat (10, 9 , 8 etj. )
- Vleresimi ishte perfunduar nga PERSHKRIMI GLOBAL i femijes: sjellja, mardhenia me shoket dhe mesuesit, angazhimi i studimit, ndjenja e pergjegjesise, kujdesi per materialet personale dhe te perbashketa etj.

### Tani

- Per secilen disipline (italisht, matematik, histori etj.) eshte parashikuar pershkrimi i **NIVELEVE** te te mesuarit.
- Vleresimi perfundohet nga PERSHKRIMI GLOBAL i femijes: sjellja, mardhenia me shoket dhe mesuesit, angazhimi i studimit, ndjenja e pergjegjesise, kujdesi per materialet personale dhe te perbashketa etj.

### Cfare jane NIVELET

Ne cdo dispilin (italisht, matematik, histori etj.) femija duhet te arrij disa **objektiva ( pra qellime ) te te mesuarit**: per shembull ne matematike duhet te mesoje te numeroje, te kryeje operacionet, te zgjidhe problemet, te beje arsyetime llogjike...

**NIVELET** jane **fjale** qe shpjegojn ne cilen pike ka arritur femija ne rrugetimin e tij drejt nje objektivi te caktuar te te mesuarit.

NIVELET jane 4 → I AVANCUAR – I NDERMJETEM – BAZE – NE PROCESIN E MARRJES FILLESTARE

Per te vendosur nivelin e arritur, mesuesit vezhgojne tek femija:

- Nese eshte i **pavarur**, domethene nese perdore ate qe ka mesuar vetem me ndihmen e mesuesit ose edhe pa ndihmen e mesuesit.
- Nese perdor ate qe ka mesuar vetem ne **situatat** qe njeh ose edhe ne situatat e reja
- Nese permbush nje detyre vetem me **mjetet** dhe **materialet** qe i jep mesuesi ose nese eshte i afte te kerkoje vet mjetet dhe materialet.
- kur perdor ate qe ka mesuar: cdo here qe i kerkohet ose kur i duhet (domethene me vazhdimesi), ose vetem ndonjehere, ose kurre.

### CFARE DOMETHENE CDO NIVEL

I AVANCUAR → Nxenesi permbush detyrat ne situata qe njeh ose dhe ne situata te reja, perdor mjetet dhe materialet te dhena nga mesuesi ose te gjetura vet, ne menyre te pavarur dhe me vazhdimesi.

I NDERMJETEM → Nxenesi permbush detyrat ne situata qe njeh, ne menyre te pavarur dhe me vazhdimesi; ne situata te reja, per te zgjidhur detyrat , perdor mjete dhe materiale te dhena nga mesuesi ose te gjetura vet, dhe pse ne menyre te nderprere dhe jo plotesisht te pavarur.

BAZE → Nxenesi permbush detyrat vetem ne situata qe njeh duke perdorur mjetet dhe materialet e dhena nga mesuesi, si ne menyre te pavarur por te nderprere, si ne menyre jo te pavarur por me vazhdimesi.

NE PROCESIN E MARRJES FILLESTARE → Nxenesi permbush detyrat vetem ne situata qe njej, vetem me ndihmen e mesuesit dhe me mjetet e materialet te pergatitura posacerisht per ate detyre.

NJE SHEMBULL

Dispilina: MATEMATIK		
OBJEKTIVAT E TE MESUARIT	NIVELI	DOMETHENE QE...
Te shpjegosh proceduren e ndjekur per te zgjidhur <b>problemet</b>	I AVANCUAR	Nxenesi ka arritur plotesisht objektivat: din te shpjegoje se si e ka zgjidhur nje problem ne menyre te pavarur, pa ndihmen e mesuesit, dhe ne situata te reja dhe ne menyre te vazhdueshme (gjithmone)
Te lexosh, shkruash, krahasosh <b>numrat dhjetore</b> , ti paraqisesh ne drejtezen.	I NDERMJETEM	Nxenesi njej mire numerat dhjetore por per momentin i perdor vetem ne situatat qe i njej mire (ushtrimet e librit, skedat, matjet ne klase). Perdor tani ate qe ka mesuar ne menyre te nderprere
Te kryesh <b>veprime</b> me numra natyror me algoritmet e zakonshme	BAZE	Nxenesi kryen kater veprimet vetem ne situata qe njej (ushtrime te perseritura shpesh), ndonjehere eshte i pavarur ne zgjedhjet, ndonjehere kerkon ndihmen e mesuesit.

**VLERESIMI I RI PER NIVELIN I LEJON PRINDERVE TE NJOHIN MIRE PIKAT E FORTA DHE PIKAT E DOBETA NE SECILEN DISPILINE DHE TE KUPTOJNE BASHKE ME MESUESIT DHE ME FEMIJEN SI TE PERMISOHEN**

\*URDHERI N 172 ME 4/12/2020

Teksti i kuruar nga PoloStart1 – ICS Rruga GIACOSA 46 Milano – janar 2021

